

Ministria e Shëndetësisë / Ministarstvo Zdravstvo / Ministry of Health
Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës
Nacionalni Institut Javnog Zdravstva Kosova
National Institute of Public Health of Kosova

Njësia org. 14
Org. Jedin. 5
Nr. i faqeve
Br. Stranka
No. Page

Nr. Prot. 2040
Br. Prot. Prot. No
Data Datum
Date

29.08.2025

Prishtinë/a

REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
SHËRBIMI SPITALOR DHE KLINIK UNIVERSITAR I KOSOVËS/UNIVERZITETSKA BOLNIČKA I KLINIČKA SLUŽBA KOSOVA/HOSPITAL AND UNIVERSITY CLINICAL SERVICE OF KOSOVO
QENDRA KOMBËTARE E MJEKËSISË SË PUNËS/NACIJONALNE CENTAR MEDICINE RADA
NATIONAL CENTRE OF LABOUR MEDICINE IN GJAKOVA

Nr. Prot. Broj prot./Prot. No. 893
Nr. i faq./Br. str./No. Page. 5
Data/Datum/Date. 29.08.2025



Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës
Nacionalni Institut za Javno Zdravstvo Kosova
National Institute of Public Health of Kosova



Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës
Univerzitetska Bolnička i Klinička Služba Kosova
Hospital and University Clinical Service of Kosovo
Qendra Kombëtare e Mjekësisë së Punës në Gjakovë
National Centre of Labour Medicine in Gjakova
Nacionalni Centar Medicine Rada u Ğakovici

Bazuar në nenin 60 dhe 64 të Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenin 42 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, nenin 17 paragrafi 5 dhe nenin 22 të Ligjit Nr. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, nenin 29 të Ligjit Nr. 04/L-125 për Shëndetësi, nenin 9 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik si dhe opinionit ligjor të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, nenin 12 të Statutit të QKMP-së, bazuar në praktikat e Autoriteteve tjera Publike si dhe në bazë të kërkesës me nr.prot.482 të dt. 14.05.2025 dhe përgjigjes në kërkesë me nr.prot.484 të dt.15.05.2025 me qëllim të bashkëpunimit në ofrimin e shërbimeve, u pajtuan të lidhin:

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Kjo marrëveshje bashkëpunimi lidhet ndërmjet palëve të mëposhtme:

Qendrës Kombëtare të Mjekësisë së Punës në Gjakovë (në tekstin e mëtejme QKMP) të cilën e përfaqëson Shpejtim Skivjani– UD. Drejtor Ekzekutiv nga njëra anë

dhe

Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (në tekstin e mëtejme IKSHPK), të cilin e përfaqëson Dr.Sc. Ardita Baraku – Drejtor Ekzekutiv.

(që në vijim “ Palët nënshkruese”)

Palët u dakorduan si në vijim:

Neni 1 Qëllimi

Marrëveshja e Bashkëpunimit lidhet me qëllim të përcaktimit të kushteve të përgjithshme të bashkëpunimit në mes të palëve të përshkruara më lartë, lidhur me ofrimin e shërbimeve të kontrollës mjekësore - vizitë sistematike për punëtorët e IKSHPK nga QKMP.

Neni 2

Të drejtat dhe obligimet e IKSHPK

1. IKSHPK ka të drejtë:
 - 1.1 Të kërkojë nga QKMP kryerjen e ekzaminimeve dhe kontrollave mjekësore;
 - 1.2 Të kërkojë nga QKMP informata lidhur me mënyrën e kryerjes së ekzaminimeve dhe kontrollave mjekësore;
 - 1.3 Në bashkëpunim me QKMP të përcaktojë orarin për kryerjen e ekzaminimeve dhe kontrolleve mjekësore në atë mënyrë që iu përshtatet të dyja palëve.
2. IKSHPK ka për obligim:
 - 1.1 Të sigurojë bashkëpunim të plotë dhe koordinim të aktiviteteve me QKMP;
 - 1.2. Të informojë punëtorët e vet, shfrytëzues të shërbimeve shëndetësore të ofruara nga QKMP, lidhur me procedurat e kontrollit mjekësor;
 - 1.3. Të përcaktojë një person përgjegjës që të monitorojë procesin e kryerjes së ekzaminimeve mjekësore;
 - 1.4. Të caktojë personelin përgjegjës për monitorimin e kësaj marrëveshje dhe përcaktimin e orarit të punëtorëve për kryerjen e ekzaminimeve mjekësore;
 - 1.5. Të sigurojë respektimin e kësaj marrëveshje.
3. IKSHPK ka për obligim të respektojë parimin e konfidencialitetit si dhe parimin e minimizimit të të dhënave si dhe të respektojë fshehtësinë e rezultateve të analizave mjekësore.
4. IKSHPK ka për obligim realizimin e pagesës për të punësuarit që i janë nënshtruar kontrollimit mjekësor në QKMP që bëhet nëpërmjet **xhirollogarisë bankare** nga IKSHPK.
5. Rezultatet mjekësore të të punësuarve mund të përdoren për qëllim të hulumtimeve, gjithmonë duke respektuar legjislacionin në fuqi në mbrojtjen e të dhënave personale dhe aktet tjera ligjore që rregullojnë këtë fushë.

Neni 3

Të drejtat dhe obligimet e QKMP

1. QKMP ka të drejtë:
 - 1.1 Të kërkojë nga të punësuarit e IKSHPK informata lidhur me vendin, kushtet dhe mënyrën e kryerjes së punës;
 - 1.2 Në bashkëpunim me IKSHPK të përcaktojë orarin për kryerjen e ekzaminimeve dhe kontrolleve mjekësore, në atë mënyrë që iu përshtatet të dyja palëve.
2. QKMP ka për obligim:
 - 1.1. Të kryejë ekzaminime mjekësore për punëtorët e IKSHPK në pajtim me standardet shëndetësore të përcaktuara sipas Ligjit në fuqi për Shëndetësi;
 - 1.2. Të sigurojë qasje të plotë në informata shëndetësore për punëtorët e IKSHPK, si shfrytëzues të shërbimeve shëndetësore gjatë ekzaminimeve mjekësore;
 - 1.3. Të bëjë kontrollin mjekësor për secilin punëtor të IKSHPK të cilët iu kanë nënshtruar ekzaminimeve mjekësore në QKMP;
 - 1.4. Të sigurojë respektim dhe korrektësi të të gjitha akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi nga ana e stafit profesional dhe mbështetës të QKMP-së në pajtim të plotë me kodin e mirësjelljes dhe përgjegjësitë e tyre në punë;
 - 1.5. Të sigurojë respektim të kësaj marrëveshje.
3. QKMP ka për obligim që të respektojë parimin e konfidencialitetit si dhe parimin e minimizimit të të dhënave, si dhe të respektojë fshehtësinë e rezultateve të analizave mjekësore.

Neni 4

Llojet e Shërbimeve Shëndetësore

1. Llojet e shërbimeve shëndetësore që ofrohen për punëtorët e IKSHPK do të jenë shërbimet shëndetësore bazuar në kuadrin profesional dhe aparaturën që posedon QKMP, të përcaktuara më konkretisht në shtojcën I të kësaj marrëveshje.
2. Pas kryerjes së ekzaminimeve mjekësore nga kuadri profesional i QKMP-së secilit punëtor që i është nënshtruar kontrollit do t'i lëshohet raport mjekësor për vizitë sistematike.
3. Përmbytja e raportit mjekësor përcaktohet sipas legjislacionit në fuqi dhe rregullave të QKMP-së.
4. Punëtorët e Divizionit të Statistikave në Qendrën Regjionale të Shëndetit Publik në Gjakovë që kanë të nënshkruar deklaratën e konfidencialitetit do të angazhohen në regjistrimin elektronik të të dhënave të anonimizuara nga kontrollat e të punësuarve të IKSHPK, për dhe sipas nevojave të IKSHPK.

Neni 5

Vendi dhe Koha e ofrimit të shërbimeve

1. Shërbimet e ofruar nga Shtojca I e kësaj marrëveshje do të kryhen në objektin kryesor të QKMP në Gjakovë.
2. Koha e kryerjes së ekzaminimeve mjekësore do të përcaktohet me një shtojcë të veçantë përkatësisht me një plan të detajuar nga të dy palët.
3. Personeli përgjegjës i përcaktuar nga IKSHPK do të përcaktojë një orar për kryerjen e kontrolleve mjekësore për punëtorët e saj nga hyrja në fuqi e kësaj marrëveshje.
4. Secili punëtor i IKSHPK do t'i nënshtrohet ekzaminimeve dhe kontrollave mjekësore sipas Ligjit në fuqi për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë.
5. Personeli i përcaktuar nga IKSHPK do të përcaktojë orar të veçantë për kryerjen e kontrolleve mjekësore për secilin punëtor të ri të punësuar.
6. Person i autorizuar për koordinim të bashkëpunimit nga QKMP në Gjakovë është Raimonda Lleshi, ndërsa person kontaktues për IKSHPK është Dr. Sebahate Pacolli Krasniqi.

Neni 6

Pagesa e Shërbimeve Shëndetësore

1. Çmimi për 1 (një) kontrollë mjekësore- vizitë sistematike është përcaktuar me Udhëzimin Administrativ 03/2024 - bashkëpagesat e shërbimeve shëndetësore të specifikuara në shtojcën 1 e cila është pjesë e kësaj Marrëveshje.
2. Në rast të ekzaminimeve shtesë, krahas pakos bazike, pagesës i shtohet çmimi i shërbimit shëndetësor i përcaktuar sipas Udhëzimit 03/2024 për bashkëpagesat e shërbimeve shëndetësore.
3. Pagesa do të realizohet nëpërmjet xhirollogarisë bankare nr. **1000400070005903**
4. Për ekzaminimet shtesë që nuk ofrohen nga QKMP, sipas rekomandimit, ekzaminimet kryhen në institucione tjera shëndetësore kurse raporti i ekzaminimit dorëzohet në QKMP me qëllim të kompletimit të raportit përfundimtar të vizitës sistematike.
5. Dorëzimi i Raporteve Mjekësore të vizitave sistematike nga QKMP tek përfaqësuesi i IKSHPK do të bëhet në QKMP, pas pranimit të konfirmimit të pagesës.

Neni 7
Mbrojtja e të dhënave personale

Të dhënat që shkëmbehen në mes IKSHPK dhe QKMP, janë të karakterit konfidencial dhe përdoren dhe ruhen në harmoni të plotë me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e konfidencialitetit të rezultateve shëndetësore.

Neni 8
Gjykata Kompetente

Palët në rast të mosmarrëveshjes, kontradiktave apo kërkesave shtesë duhet që të njëjtat t'i zgjidhin në mënyrë miqësore, përmes negociatave duke pasur parasysh përfitimet që të dyja palët kanë nga kjo marrëveshje, rëndësinë e zhvillimit të sigurisë në punës dhe mjekësisë së punës në Kosovë, në rastin tjetër, kontesti zgjidhet nga Gjykata Themelore kompetente.

Neni 9
Modifikimi i marrëveshjes apo shkëputja e saj

1. Kjo Marrëveshje e Bashkëpunimit mund të modifikohet apo të shfuqizohet në mënyrë automatike me hyrjen në fuqi të ndonjë ligji, fushëveprimi i të cilit prek ndonjë nga pikat e kësaj marrëveshjeje, apo aktet tjera nënligjore, dispozitat e të cilave janë në kundërshtim me këtë Marrëveshje.
2. Çdo ndryshim eventual i kësaj marrëveshjeje do të shtohet si aneks dhe hyn në fuqi me nënshkrimin nga përfaqësuesit e institucioneve implementuese të kësaj marrëveshjeje.
3. Secila nga palët mund të tërhiqet brenda tridhjetë (30) ditëve pas paralajmërimit paraprak me shkrim.
4. Kohë e paralajmërimit do të konsiderohet data e pranimit të letrës paralajmëruese.

Neni 10
Hyrja në Fuqi

1. Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi hyn në fuqi me nënshkrimin nga përfaqësuesit e autorizuar të palëve të marrëveshjes.
2. Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi është përpiluar në katër (4) ekzemplarë identikë, nga dy (2) ekzemplarë për secilën palë nënshkruese.

Palët nënshkruese:

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës

Përfaqësues i autorizuar:


Dr.Sc. Ardita Baraku, Drejtor Ekzekutiv



Qendra Kombëtare e Mjekësisë së Punës

Përfaqësues i autorizuar:

Shpejtim Skivjani – U.D. Drejtor Ekzekutiv.



Gjakovë, 29.08.2025

Shtojca I:

OFERTA bazike -II

1.Ekzaminim Specialistik nga Mjeku i Punës	dy (2) euro.
2.Oftalmologu	dy (2) euro + Fundus kamera tre (3) euro = 5 euro
3.Neurologu (opsional Psikiatri)	dy (2) euro.
4.Internisti	dy (2) euro.
5.EKG	një (1) euro
6.Otorinolaringologu	dy (2) euro + Timpanometria dy (2) euro + Endoskopi tre (3) euro = 7 euro
7.Radiografi e krahavorit	katër (4) euro
8.Pulmologu	dy (2) euro + Spirometri pesë (5) euro = 7 euro
9.Analiza Laboratorike (SE,hemogram,glicemia urea,cholesterol,trigliceridet,Alt,Ast,Urina)	pesë (5) euro
Gjithsej tridhjetë e pesë (35) euro	

Në kuadër të analizave laboratorike mund të realizohen edhe analizat të cilat janë të përcaktuara me çmimet përcjellëse:

VIT D	dhjetë (10) euro	
TSH	dy (2) euro	
PSA	dhjetë (10) euro	
Ca-19-9	dy (2) euro	(tumormarker i kancerit të sistemit gastrointestinal)
Ca- 125	dy (2) euro	(tumormarker i kancerit të vezoreve)
Ca- 15-3	dy (2) euro	(tumormarker i kancerit të gjiut)

Çmimi për një (1) person sipas Ofertës bazike II, të përcaktuar më lartë, së bashku me analizat laboratorike përcjellëse të përzgjedhura, është si në vijim:

(vit.D, TSH, Ca-19-9, Ca -125, Ca15-3)	për gra – pesëdhjetë e tre (53) euro
(vit.D, TSH, Ca-19-9, PSA)	për burra – pesëdhjetë e nëntë (59) euro

Sqarim

- Çdo ekzaminim shtesë laboratorik apo specialistik që nuk është përfshirë në paketën bazike të lartshënuar paguhet sipas çmimoreve në fuqi.